

NIKO KACALIDHA



tjalë  
të  
thëna  
në  
pranverë

VJERSHA

8PI.P83-1

R 13


3

NIKO KACALIDHA

# Fjalë të thëna në pranverë

(VJERSHA)

~~55804~~



12804

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SIKUR MË THONË MALET E VENDLINDJES

Sikur më thonë malet e vendlindjes:  
«U bëre burrë mor djalë, u rrite shumë,  
A të kujtohet bryma e lirishtes,  
Po lundrat e fëmijëve mbi lumë?»

Ne të freskuam krojeve të ftohta,  
Të falëm frashër dhe trumpeta bëre,  
Të dhamë shkopinj prej thane dhe lajthie,  
Dhe çfarë s'të dhamë mëngjezeve ahere.

Në breglumenj porsi bohem u ktheva,  
Më rritët ju, u bëra burrë në jetë,  
U ktheva unë t'ju lidh mbi kodra llamba  
Që të bleroni sot nën dritë të blertë.»

Sikur më thonë malet e vendlindjes:  
«Na shkruaj, bir, një varg ose një vjershë  
Që të qëndrojë pranë llambave që ndeze  
Nga biri ynë mbi mal si buzëqeshje»



## PALLATI I PROGRESIT TEKNIK

Atje tutje i ndez dhe i fik dritat një pallat (ndryshe  
nga pallatet e tjera),  
Drita të shumta dhe të shumëngjyrshme e rrethojnë  
atë.

Përherë kur dal mbrëmjeve, nën neon u them  
shokëve: këtej.

Nuk e di ç'dashuri të veçantë kam për këtë pallat  
Mbrëmjeve kur dal,

Kur përendimi si pyll i dendur laget i tërë tutje  
në drita,

Ku skuq me germa kapitale «Pallati i progresit  
teknik»

Me tri fjalë të një gjuhe të huaj  
Të lidhura me nyjen «i» të shqipes.

Përherë kur dal mbrëmjeve, nën neon u them  
shokëve: këtej.

Dhe kalojmë pranë këtij pallati  
Ne, miqtë më të ngushtë të progresit.



Atje tutje i ndez dhe i fik dritat një pallat (ndryshe  
nga pallatet e tjera).

Drita të shumta dhe të shumëngjyrshme e rrethojnë  
atë,

Që bien mbi projektet e lokomotivave që ende s'kanë  
vërshtëllyer,

Që derdhen mbi projektet e motorave që nuk janë  
ndezur ende.

Përherë kur dal mbrëmjeve, nën neon u them  
shokëve: këtej.

## NJË NATË NË MAL

Retë si delet iknin larg,  
U kthjellua mali e bregu.  
Unë u nisa atje të shkoj  
Mandrave ku dukej shtegu.

Dolën yjet përmbi lisa,  
Tutje ndriste zjarr i madh,  
Thirra si një mik i vjetër  
Që kam shkelur aq livadhe:

Ej, barinj, pa lidhni qentë!  
Doli zëri im si çangë,  
Por barinjtë i kish magjepsur  
Iso e këngës «dambe, dambe...»

Ishte natë në mal, nën yjet  
Zbardhnin tej majat me borë;  
Tek e tuk lëviznin delet;  
Natë e viseve hënore.

Me një shok veteriner  
Ngrohnim qingjat mirrnim këngën,  
Dhe barinjte i bënin iso  
Bukur këngës dambe, çambe...»

Gjer n'agim kur zbardhën kodrat  
Barinjte qingjat përkëdhelën.  
Nesër kodrave do hapej  
Një kope e re me dele.



## PËR DRERIN, PËR DRURIN, PËR DRITAT

### 1

Dreri rendte mes borigash  
Dhe mbi sup blerimin mbarte,  
Ikte nata përtej brigjesh  
Si një korb mbi monopate.

Tutje binin bijtë e malit  
Që do mbeteshin mbi buste,  
Dreri i egër dredha-dredha  
Borën krejt me gjurma mbushte.

Dhe kur rëndë nën hije lisash  
Dergjej trimi shtrirë nga plagët.  
Thonë se dreri shkonte i heshtur  
Mos ta zgjonte... edhe qante.

### 2

Dhe u rrit druri pranë hënës  
Qiti degë, nxori blerim;

Në legjendat që rrëfehen  
I kujtohen bombardimet.

Deshi që ta thante bredhin  
Plumbi i huaq me rrëmbim  
Edhe trimërinë ta mbyste  
Tejmbanë relievit tim.

Shpesh pranë tij kaluan vitet  
Me alarme, kujë, legjenda,  
Dashuria e tokës rritet  
Për brigadat, trimat, këngët.

3

Zbriti mbrëmja përmbi bredha  
Pa mantela e tallagane,  
Thellë në pyll u futën burrat  
Përmbi supe shtyllat mbanin

Më të gjatin dru të bredhit  
E vendosën mu në qendër,  
Shfaqen lart izolatorët  
Drita shkon ndanë monumentit.

## KROS VJESHTE

Portat e vjeshtës hapi era e parë.  
Pallati i mjelmës ra  
Dhe zunë shirat,  
Ndërsa mëngjezi i parë i vjeshtës prapë  
Me kryet flokëverdhë  
Vërshëlleu si vigan me muskuj përmbi shina.

Rrugët u lanë dhe era u ngrit lart.  
U ngritën çadrat lart  
Kur shoqja jonë u nis drejt kombinatit  
Dhe mbante vjeshtën  
Në ca hurma në borsetë.  
I pari urban u nis diku,  
Pastaj u nisën varg të tjera urbane  
Plot me njerëz,  
Ashtu dhe vera brune parqet la,  
U përshëndet me dashuritë  
Dhe dasmat la në vjeshtë.

Rrëzë mullarëve të fshatit struket gjethi.  
Zbret katundit herët sot



Fshatari dhe fshatarka.  
Mjelma e vjeshtës poshtë në lumë  
Zbret në trojet e një ferme,  
Gjen fshatarin plak që ruan patat.

Portat e vjeshtës hapi era e parë,  
Treni i parë u nis dhe hapi vjeshtën,  
Zbret kopeja që veroi në mal  
Dhe në stallën e fermës futen deshtë.  
Vjeshta hapi rrugët me gëzimin e dasmave  
Dhe na gjeti kudo në rrjeshta,  
Mëngjezi flokëverdhë me dashurinë e hurmave  
Na ftoi në krosin e vjeshtës.

## RRËMBIMI I STATUJAVE TË BUTRINTIT

Nën qiellin e zi, konik të natës zbardhnin poshtë  
statujat.

— Natën e mirë, qiell konik!

— Natën e mirë, statuja!

Net të zeza me heshtje,

Net memece ku vuajtën statujat nga rrëmbime  
tragjike.

Relievi zbardhte dhe qante duke zbardhur,

Mermeret qanin,

Statujat qanin,

Kaktuset qanin,

Qanin tempujt dhe shtyllat me bardhësinë antike.

Natën e mirë qiell konik!

Natën e mirë statuja!

Ç'ndodhte në netët jonike, o shekull i njëzetë?  
Kish koh', e dinim që drama më s'u shfaqën,  
Kish kohë që heshtja shëtiste në Butrint.

Në mes të heshtjes statujat bisedonin në breg të  
detit me idile,  
Çifte-çifte dilnin nën pyjet me ullinj,  
Kurse në skena tej në botë gjëmonin dramat,  
Kopjonin nëpër skenat me shtyllat anash dhe siparet  
lart

Nazet e Piros,  
Zjarrin e Andromakës.  
Duartrokiste bota artin tënd, tempujt, bustet, kalatë.

Nën qiellin e zi, konik të natës zbardhnin poshtë  
statujat.

Përse statujat atë natë mërdhinin?  
Ç'kishin statujat që tokës ngulnin këmbë?  
Në qytetet e botës avitej lufta me hapat fashistë  
Hidhte shkallët në muret e shteteve  
Dhe vinte flakë, dhe vinte flakë.  
Ahere popujt lanë parmendat, vetmia i lidhi buajt,  
Skenat braktisën aktorët; siparet ranë në heshtje.

Topa nuk kishim por male kishim plot;  
Pak armë që kishim,  
S'na turpëruan në rrebesh të shtrenjtat armë,  
Duke gjëmuar në rrebesh të shtrenjtat armë u bënë  
të madhërishme.



Nën qiellin e zi, konik të natës zbardhnin statujat në  
Butrint.

Natën e mirë qiell konik!  
Natën e mirë statuja!

Erdhën karvanet në Butrint, në breg prisnin anijet.  
(Ashtu porsi anijet e grekërve në brigje  
Elenën të rrëmbenin, të shkatërronin Trojën)  
Me sëpatat përmbi bord Benito Musolini  
Dërgoi anijet brigjeve statujat të rrëmbenin.  
Mermeri i ftohtë ethe kishte, temperaturë kishte!  
Net të zeza me heshtje,  
Net memece ku vuajtën statujat nga rrëmbimet  
tragjike.

Një dramë e fundit shfaqej në Butrint,  
Trupi i mermerit dridhej nëpër ethe  
Në atë relief të bardhë ku nën ullinj  
Zbardhnin statujat.  
Vetë autor dhe vetë protagonist  
Kreu rrëmbimin dramatik Benito Musolini.

Ato që iknin mbi borde piratësh veç heshtnin.  
Ato që mbeteshin krahët coptonin nga marazi për  
shoqet që iknin.

Ku i çonin statujat me në krye Apollonin?  
Hidhnin viset e Jugut nga inati dëborë,  
Edhe krismat e armëve gjumin ia prishën  
Monstruoazit Benito e Viktor perandorit.

## SONTE

Sonte s'dua të fle, jo nga marazi i dashurisë si  
Milosaoja,  
Që mbeti në netët e gjata magjike me ëndrra ç'a-  
shurie në peisazhin baritor.

Sonte vërtiten pëllumba të bardhë drite.  
Nën një qiell të gjerë e të kaltër të dritës.  
Fëmijët në rrugë trokasin duart për ardhjen e zam-  
bakut të kuq.  
Nënat tona ndezin globin e dritës, sikur ndezin një  
hënë.

Vajzat nën shtylla grumbuj-grumbuj këndojnë këngë.  
Në brigje, nën shtylla, mbi shtylla, nën dendësinë e  
dritave ndizen këngë.

Sonte jam me ta  
Dhe do jem me ta.  
Sonte me fëmijët në rrugë trokasim duart.  
Sonte me nënat tona ndezim në dhomë hënë.

Sonte me shoqet nën shtylla këndojmë me ison  
e krahinës.

Në brigje, nën shtylla, mbi shtylla.

Gjumi s'më zë në peisazhin e ri të dendur të dritës.



4

## NATË ME HËNË TË EMBËL MJALTË

Era vërshëllen si rojtar pyjesh  
Kur në fund të pyllit ndihet një sëpatë,  
Mua më ka dehur aroma e korijes  
N'ekspeditë arkeologësh këtë natë.

Ne vështrojmë mozaike, antika dhe pìrgje  
Këtë natë me hënë të ëmbël mjaltë.  
Poshtë përplasen deti nëpër brigje,  
Dritat dridhen detit si mirazh.

Harta jonë ç'mbështillet nën hënë,  
Shtegëtojmë mbi të si barkë me vela.  
Nesër fillojnë gërmimet në bregdet;  
Dikur këtu ankoronin karavelat.

Brigje të dashura, erë rebele,  
Mblich ti kujtimet bionde,  
Që unë arkeologu me kapele  
T'i kem nga bregu i detit Jon.

## PEISAZHET ÇELIN LULE

Tani, kur peisazhet çelin lule  
Në dendësinë e grurit të bleruar,  
Në breg të lumit erdha me maqinë,  
Kallinj të njomë tundja nëpër duar.

Lumenjtë i nisim valët me rrëmbim,  
Me sulme dhe ndalesa nëpër stina,  
Unë sot piketa ngula breg më breg  
Me ekspeditën më të re të projektimit.

Pranvera e blertë tundej breg më breg  
Kur erdha me maqinën me projekte.  
Në mes të fushës ca qerrtarë të mirë  
Me dorën ngritur lart na përshëndetën.

Në rrugë uronin njerëzit e mirë,  
Na sillte era fjalët pas maqinës,  
Përreth këndonin zoçkëzat në gjeth  
Këngët e bukura të stinës.

Te kjo ndalesë që ngrihet si kështjellë  
Që çon jehonën tutje gjeratores,  
Sot vijnë të lidhin brigjet me beton,  
Sot vijnë maqinat me projekte dhe punëtorë.

Dhe pranvera tundet breg më breg,  
Rrëshqet aroma e mollës nëpër gjethe,  
Këtu po ndizen llambat përmbi digë,  
Këtu u nderën çadrat plot projekte.



## FLUTURIMI I ZOGUT

(Peisazh bashkëkohës)

Kush e di nga vinte ai zog me fluturim që ndejti  
përmbi tela,  
Mbi ç'degë të dendura limonjsh këndoi, ku e kish  
folenë ai?  
Erdhi dhe ndejti aty mbi shtylla telefonash dhe  
vështronte poshtë  
se si kalonte treni përmbi shina.  
Vështronte urën zogu i brishtë pupla-pupla blu,  
Mbi urën rendte treni, poshtë maqinat,  
Dhe iknin prapë dhe zhdukeshin në fusha.  
Zogut mbi tela nga gëzimi i dridhej gusha.  
Lëvizte majtas, djathtas kok' e vockël përmbi tela  
Si një kurioz i çuditshëm që pret dhe përcjell nëpër  
fushë maqina dhe trena.  
Erdhi nga pyjet tona ai zog me sqep të bukur,  
Erdhi nga pyjet tona ai zog me zë më të bukur se  
sqepi  
Të këndonte mbi urë kur të kalonte treni i  
ri ekspres.

Në dritaren e trenit që mbështetur poeti dhe zogun  
e pa,  
Dhe shkroi vargje për limonj, për trenat dhe për  
zogjtë,  
Dhe shkroi vargje për zogjtë që qëndronin mbi tela.

Dhe erdhi nga pyjet pikërisht këtë ditë  
Kur inauguroheshin rrugët e gjera të trenave dhe  
të maqinave  
Sikur inauguroheshin edhe dëshirat e zogjve për një  
nisje drejt kopshteve me limona e portokalle.

## GJER TE PRAKU I PORTËS TË PËRCOLLA MBRËME

Midis brigjeve të lumit ura e vështrimeve.  
Bij e millonait — bisku mes blerimeve.

Nga mur' i mullirit një gur hodha dje,  
Bij e millonait, herët më ke ndjerë.

Gjer te praku i portës të përçolla mbrëmë,  
Ç'të tha millonai, ç'të foli jot' ëmë?

Pranë shtëpisë së millonait erdha mbrëmë vetë,  
A mos isha vallë dhëndrri që jot' ëmë pret?

Thellë fushës ç'o punojmë midis vullnetarëve...  
Unë dhe bij e millonait rendim mes ugareve.



## KUR DOLI YLLI I KARVANIT

Shkove pas babait në lagjet e botës duke bërë  
kanistra  
dhe fëmijët thërrisnin: ku je arixhi, plak o arixhi,  
Kurse djemtë e lagjes dilnin në dritare  
të shikonin ty, vajzë e arixhiut.

«Hop e hop ari», i bërtiste plaku valles së ariut,  
O i trash ari me putrat e rënda.  
Kë vështronte vallë vajza e arixhiut?  
Ç'e vështronin vajzën djemtë dhe buzëqeshnin!

Mbrëmjet kur kalonin, vajza gjumë nuk kishte,  
Diçka pëshpëriste, ç'ëndërr shihte në gjumë?  
Mos shihte ariun, plakun me kanistra  
Dhe shelgjet e holla atje poshtë në lumë?

O, në gjumë i vinin ata djemë të lagjes,  
(Nga uzinat ktheheshin në qytet).  
O, në gjumë i vinin rrotull karuselat,  
Britmat e fatosave «shoqet bëjnë balet».

O, në gjumë i vinte plaku me kosore  
Që s'donte ta çonte vajzën në uzinë.  
Shkoi lagje më lagje, shkoi pas arixhiut duke bërë  
kanistra  
Dhe i ngryste mbrëmjet vajza në vetmi.

Me kusinë e hënës derdhte ajo vajzë melodi cigane  
Dhe pastaj ia nisnin zogjtë poshtë në lumë,  
Ajo pranë kasolles ëndërroi uzinën;  
Netët e bohemës nuk i zuri gjumi.

Dhe kur çeli malit ylli i karvanit,  
Dhe kur derdhej pyllit vesa si inxhi  
La kasollen prapa duke shkelur brymën  
Dhe të iku vajza. plak o arixhi.

Ç'i kënduan vajzës shkurrë më shkurrë bilbilat.  
Ç'i bënë fresk vajzës shelgjet poshtë në lumë  
O, ç'i ndriti flokët lart yll' i karvanit,  
Plak o arixhi ty të la në gjumë, ty të la në gjumë.

Iku dhe trokiti te dera e uzinës  
Një cigankë e bukur ardhur në qytet,  
Zëri i fatosave që nga rruga i vinte  
...«shoqet bëjnë balet».

Pas ca ditësh panë nëpër rrugë fëmijët  
Plakun arixhi, plakun me kosore.

Po ç'u bë ariu, vajza e arixhiut me kanistra e shporta?  
Vajzën arixhiu rrugëve kërkonte.

Ç'e mësuan shoqet vajzën në kombinat  
Si të endë pëlhurën, si të bëjë xhakartë,  
Nëpër yll t'karvanit vajza nisi rrugën  
Duke shkelur brymën, pellgjet plot me baltë.



## QYTETI I GURIT

Tutje derës së broncit i ngre pirqjet qyteti antik  
i gurit.

Këtu çdo gjë që e gurtë. Perënditë, perandorët dhe  
ligjet.

Bardhësia e çuditshme e hënës nxiste ëndrra  
Dhe pastaj i mbyste harrimi.

Këtu çdo gjë që e gurtë.

Barbaria e prijsit shtrihej në këmbë lakuriqe perë-  
ndeshash të bardha prej mermeri.

Skllëvër kudo binin kurban.

Në mes të qytetit të gurtë, perëndesha barbare  
kënaqej.

Kënaqej me ushtrimet e legjionarevet që varg-varg  
prisnin koka.

Paske qenë barbare moj perëndi e mermertë e qy-  
tetit antik!

Përmendoren tënde ta kanë ngritur skllëvërit jo  
se të donin,

(Aspak ata s'të donin).

Mbeteshin urave skelete sklevërish të ngarkuar me  
gurë

Dhe kalonin mbi ta me bujë paralele me hipote-  
nuzën e urës

Koka centurionesh me triumfin e rremë.

Ku shkonin këta centurionë monstruoze të qytetit  
të gurit,

Me urat që hidhnin nga bregu në breg?

Dilte jashtë derës së broncit falanga e frikshme e  
perandorit

Duke tundur shpatat, duke ngitur shpatat

Dhe sklevër grabiste mes monotonisë së luftës dhe  
të fushimit.

Kështu u nise dhe drejt fisit tim,

O barbari e egër e perëndeshës së gurtë!

O barbari perandorësh sadistë!

Shanin aty, këtu, breg më breg. Sharje. Klithma  
latine

Pëlciste guri nga nxehtësia e djegjes së gurit.

(Sa grurë na dogjën barbarët ndër shekuj!)

Shtruan me gurë një nga një si me rrokje latine  
relievin që i urrente

Dhe doli Via Egnatia.

Sot mbetën gjurma. Rrjeshta në faqe librash,

Ndonjë urë e vetmuar në harresë që s'i shërben  
njeriu,

Gurë të nxirë, kthesa, dhe kaq.

Egnatia mbeti në lashtësi në rrjeshta librash si një  
muze i gjatë.

Nën dhe kalben skelete dhe shpata të thyera.

Mes rrënojave, gjokszbërthyer — lavdia e kombit  
që s'duroi armiq.



## KTHIMI I TË TREQINDVE

Mbi dëborën e alpeve një dori vrapon,  
Nga vrapimi i kuajve, kresht' e mal jehon.

Nga shkëlqimi i shpatave fush' e mal shkëlqen,  
Treqind trima kthehen, kështjellën rrëmbejnë.

Fushë e mal ndriçon nga shkëlqimi i shpatave,  
Mbi male shtegëton zjarri i shqiptarëve.

## BALLADË

Ç'u thanë qiparizat në breg t'Arbërisë,  
Ikën dallëndyshet nga i shtrenjti vis.

Mbi degë lofatash vajza rri në krua.  
Turqit prangat hodhën dhe i lidhën duart.

Bucela pranë kroit mbeti vetëm. Larg  
vajzën e dërguan në Çanak Kala.

— Gjergj o trim, o lule dil si qipariz  
Se na çuan vajzat përtej Arbërisë.

Mbi trojet me bredha Gjergji kalin nget,  
Nesër shpat' e trimit, turk i zi të pret.

Ç'u çelën limonat në breg t'Arbërisë  
Kthehen dallëndyshet në të shtrenjtin vis.

## . PLAKU DHE PLAGËT

Bilbilit nuk ia mbyl zërin rrebeshi,  
Një zë që del nga zemra nuk humbet.  
Një plak, porsì pranvera buzëqeshte  
Se priste ditë të bardhë në këtë jetë.

I shkundi plot dëborë mbi krye koha.  
Për nipat shkronja ndante nëpër rrugë,  
Nëpër kalldrëme turku i hidhte kokën,  
Vdiste për ne i shtrenjti plak Bab' Dudë.

Vuajtjet s'iu peshuan me kandare  
Kur turku një nga një flokët ia shkuli.  
Qyteti mblidhte grushtat në dritare  
Dhe mali retë si perde poshtë i uli.

I vinin rrotull fushat, rrugët, malet  
E torturuan plakun, plagë e bënë,  
Në rrugët e kalldrëmta të mëhallës  
Dhe i vdekur belbëzonte a, be, ce-në.



## DRAMA E ORIZIT QË S'U KORR

Mbrëmë përsëri në konvikt çelën dritat,  
Ne ishim kthyer në dhomë nga zbori.  
Një shok kinez nga malet ku kaloi dikur feniksi  
Më tregoi  
Për dramën e orizit që s'u korr,  
Për bujkun që vranë dhe kasollen ia dogjën,  
Për çifligarin katran me surrat porsi korbi,  
Për të gjitha mallëkimet e fisit.

U vra bujku i tokës në kasollen e vet.  
Bujkun e vranë se ai kundërshtoi,  
Pranë kasolles mbeti një metër katror me oriz.  
Vdiqën bijtë e tij,  
Kush ta korrte orizin?  
Çifligari dogji kasollen me zjarr  
Dhe vetmia e erës orizin e vetëm kosiste.

Fshati pillte një këngë me tambure dhe fyej,  
Nga dashuria për vendin në tokë mbinte bari.  
«Sa ëndrra, sa ëndrra», — thotë shoku, —

«Sa ëndrra bashkë me jonxhën na kositi çifligari!»!

Gruaja e tij u çmend pasi lindi djalë dhe i vdiq.  
(Thonë se u çmend nga turpi,  
Se qumështin e saj e kërkoi çifligari!)  
Thonë se dilte shpesh e shplekste leshrat nën  
hënë  
Dhe të gjorën e gjetën të mbytur diku  
Bregut të lumit.

Çifligari pinte qumësht nga gratë  
Si përbindësh i egër, i urryer,  
Gjersa derën e tij, me tambur dhe alarme.  
Bijtë e kuq të popullit  
Me qytën e pushkës e thyen.

Ne që e duam shumë tokën tonë  
Kjo dramë na rrënjëqethi,  
Për vetminë e kasolles, orizin që s'u korr edhe  
çmendjen.  
Dhe, shfaqjen mbi kasolle të rënjes së gjethit.

«Këto, — thotë shoku, — m'i tregoi në fëmëni  
Gjyshja ime flokëbardhë  
Në mbrëmjet e kaltra kur vinim nga puna.

Për dramën e orizit që s'u korr  
Bile një këngë të gjatë krijoi komuna.

Kjo qe drama e orizit që s'u korr,  
Në vitet me çifligarë të urryer.  
Tashti në komunë vetë mbjellim, vetë korrin.  
Mbi konturin e viseve derdhet drita si diell».



## NA ZURI AGIMI MBI SKELA

Erdhe dhe ti në këtë qytet të ri  
Me mendimet e bukura për ndërtesat e reja.  
Erdhe dhe ti me projektet nën sjetull  
Dhe na zuri agimi të dyve mbi skela.  
Diçka i pëshpërisnim njëri-tjetrit,  
Diçka i thoshim.  
Erdhe dhe ti në qytetin e ri  
Dhe ngritëm pallatet e reja dhe dashurinë tonë.  
Shumë gjëra folëm,  
Shumë gjëra thamë,  
Dhe na zuri agimi të dyve mbi skela.

## ZBRES NË RRUGË VETË I DYTË

Sa herë kam kaluar pranë teje mimozë,  
Ndanë rrugës përherë ke qëndruar si nuse!  
Sa herë në mëngjeze kam zbritur në rrugë  
Dhe ti moj mimozë me lule na mbushe.

Sivjet prapë më hodhe si furça piktorësh  
Shpërthime të para që ke thellë në gjë,  
Unë prapë në mëngjeze po zbres zemërgjerë  
Sivjet shkoj pranë teje, i ri, vetë i dytë.

E njoha një shoqe kur vjet binarët shkarkonim  
E shinat shtronim e shtronim gjer larg,  
Prandaj petalet e tua prapë shkundi,  
Mbi çiftin e lumtur, mimozë, shkundi prapë.

Ja, erdhën pranë derës mëngjeze të tjera,  
Aksione të reja me diell në shtigje,  
Në vendet që dua do jem bashkë me vajzën.  
Nën ahet e larta, në viset me brigje.

## DIÇKA THANË PANJAT DHE ÇELËN

Ne nuk mbetëm memecë në heshtje,  
**Të** gjitha gjërat që thuhën i thamë.  
Kur erdhi koha e takimit  
Përse nuk the asnjë fjalë?

Fluturuan pëllumbat mbi qytet,  
Diçka thanë panjat dhe çelën,  
Pse shpërthyen panjat për ty,  
Ku e morën vesh pëllumbat që erdhën?



Më ndoqi larg vegimi yt, më ndoqi pas,  
Në ëndrrën time kopsht me jargavane ngrite,  
Kudo që shkoj, kudo që jam  
Më duket sikur pas më ndjek vështrimi i çiltër.

Dhe ika larg një ditë nga ti  
Me dashurinë mbi supe hedhur si refleks,  
Që të ndërtoj qytete me punëtorët,  
Të vish dhe ti pas meje një mëngjez.

Më ndoqi larg vegimi yt, më ndoqi larg,  
Në ëndrrën time kopsht me jargavane ngrite,  
Kudo që shkoj, kudo që jam  
Më duket sikur pas më ndjek vështrimi i çiltër.

S'pyete për pëshpëritjet prapa qoshes,  
S'pranove tjetër zemrën të ta çelte,  
Dhe pas vegimit erdhe një mëngjez  
Te unë si një agim i bardhë, i çiltër.

## NGA PLEPAT DOLI HËNA

Gjurmat i le mbi rërë  
Në ditët ujore të plazhit  
dhe ike.

Pylli i dendur i perëndimit  
Mbyllte dritaret e fundit.  
Ti ike,

të mori treni i fundit  
Dhe nga maja e plepave të plazhit doli hëna.  
Një mbrëmje tjetër.

Me një tren të tillë ika dhe unë.  
Në plazh të tjerë laheshin  
Dhe dashuroheshin,  
Nga maja e plepave të plazhit  
përsëri pas nesh doli hëna.

Gjurmat i lamë mbi rërë  
Në ditët ujore të plazhit  
dhe ikëm.

Nuk do të ndahemi edhe në qytetin e madh.  
Drejt të cilit na çon treni dhe dashuria.

## FËMINIA, UNË DHE SHOKU

Rendëm në fëmini duke tundur shëlgjet,  
Hidhnim gurë në lumë dhe trazonim valët,  
Dhe ngjiteshim në majat e qershisë  
Dhe u ngjiteshim prapa ushtarëve.

O, unë kisha shumë miq, unë kam shumë miq  
Rrokëm duart rrap më rrap e brodhëm bredh më  
bredh,

Në mbrëmjet e shndritshme industriale  
Kënduam së bashku dhe këngë.

Rendëm në fëmini duke tundur çantat  
Nën lisat plot vesë të lartë gjer në hënë,  
Shkronjat numëronim me gishtat e njomë.  
Ky ka qenë për fëmininë numërim modern.



Me shokun tim të fëminisë pranë lumit tundëm  
shelgjet...

Ç'më erdhi prapë këtu në vjershën time!  
Atij i vari pranvera mbi supe rroben e blertë,  
Mua më shkundi mbi vargje blerime.

## ZOGU I DËBORES

Dëbora binte tejembanë  
Zogjve u dridhej gjoksi,  
Mbi degët e ngarkuara me borë  
I fortë qëndronte borsi.

Zogjtë strukeshin në guva që me natë  
Gjersa bora të shkrinte.  
Ai nuk çante kokën mbi okitë;  
Dëbora le të binte.

Ç'ishte ai zog që rrinte në të ftohtë  
Mbi degët e një dardhe,  
Si ndonjë bard lirik i gjerë  
Që andej peisazheve të bardha?

Dëbora binte tejembanë  
Zogjve u dridhej gjoksi.  
Shtegtonin zogjtë n'Arabistan  
N'okitë qëndronte borsi.

## VAJZA NË FORTEPIANO

Të rrodhi drita e hënës mbi tastierë  
Flokët të ranë dhe të ngatëruan notat,  
Të erdhën peisazhet pranë e pranë,  
Edhe mëngjezi muzikor si me shkopinj  
Erdhi dhe të trokiti aq naiv një ditë te porta

Dhe ti mbi fortepiano diçka the...  
I re diku, kush t'u përgjigj?  
(Kush buzëqeshi si një vijë e zgjatur mbi tastierë  
dhe mblodhi në një heshtje hapësirat?)  
Një vijë e zgjatur mbeti pas sikur kaloi një tren  
me këngë  
dhe prapa la publikun duke thirrur.

Pranë këngës tënde jashtë në xham sa zogj të bardhë  
këndojnë,  
Sa zogj çuçurisin në dritaren tënde,  
Mbi fortepiano ti vazhdove melodinë  
Sikur u thoshe zogjve: hajdeni, hyni brenda.



Nga xhami binte drita e hënës flokët duke larë,  
Dhe zgjaste kokën hëna të dëgjonte,  
Dhe ti e re, e re mbi pentagram  
Shfletove partitura dhe kërkove nota.

Ashtu si rrinte hëna jashtë në xham  
Të rrinte dhe babai yt pas derës,  
Ai plak i thinjur, borë i bardhë  
Në fëmininë tënde sikur gjeti  
Atë që nuk e gjeti kurrë në fëmininë e tij të hershme.

Në kopshtet e pranverës a të vjeshtës  
kur shkel barin jeshil ose një gjeth,  
Përbrenda teje e çiltër ndizet kënga  
Dhe ti pastaj shpërthen në buzëqeshje.

Dhe ti do kthehesh ndonjë mbrëmje në shtëpi  
Dhe prapë në fortepiano do të ulësh.  
Me vrull të derdhësh notat si stuhi,  
Nga dashuria e parë për ty do çelin lule.

Dhe ti do kthehesh mbrëmjes në shtëpi,  
Kuriozë do mblidhen zogjtë në dritare.  
Ashtu këndojnë të gjithë kur dashurojnë  
Nga zjarri i madh i dashurisë së parë.

## FUNDI I DHJETORIT

Ranë pikat e fundit të shiut.  
Na ikën, na lë  
Dhe një vit.  
Te dhoma e konviktit, i ndezur  
Pranë krevatit abazhuri  
Shndrit.

Ne çantat bëjmë gati të ikim  
Me trenin ekspres për në Jug,  
Dhe shokët dhe shoqet do ikin  
Në viset e bardha  
Plot rrugë.

Vështroj nga ballkoni i konviktit,  
Shokët zbresin  
U çon era flokët.  
Dispencat i lashë komodinës  
Do iki sot dhe unë bashkë me shokët.  
Pushimet e shkurtëra të dimrit  
Të vetëm i lënë  
Auditorët.

Dhe unë pardesynë herët vesha  
Dhe çadrën dhe çantën në dorë.  
Në rrugë ambulantet ndriçojnë  
Kartolinat  
Me pisha ngarkuar me borë.  
Dhjetori mban erë portokalli  
Dhe rrugët, urbanet  
Dhe parqet,  
Pushimet e dimrit afrohen  
Dhe mua vendlindja më shfaqet.

Pushime të mbara,  
Urime.  
Në Jug, në Veri,  
Të bardha janë rrugët e dimrit;  
Në rrugë do më gjejë Viti i ri.



## TUNDEN GJETHET NËPËR KËNGËN TËNDE

Eh, në këngën tënde çelin portokallet,  
Tundin degët qitrot si duartrokitje,  
Ç'më jehon së largu një këngë përmbi valë,  
Kënga e Kosta Çavos që ra n'ato brigje.

Eh, brigjet e Jugut që të panë si rende  
Tundën portokallet të nderojnë trimat.  
Ti i gjallë, i qeshur si një yll mbete,  
Erdhe dhe trokite në kujtesën time.

Çelin portokallet nga iso e këngës  
Që fryn mbi gështenjat, mbi bredhat e boçet  
Në molot e Jugut gjeta rininë tënde,  
Në brigjet e kaltra, brune, ngjyrëvjollce.

Më ngjan sikur ngrihesh që me natë mbi kodra  
Të vështrosh bregdetin plot agrume e grurë,  
Dhe sikur pas teje vajzat shamibardha  
Përmes fushës rendin me drëpinjtë në duar.

Ç'më jehoi një këngë thellë nga ato vite  
Kur mbi portokallet ndizej perëndimi,  
Në brigjet e kaltra, brune e ngjyrëvjollce  
Rrodhi nga agrumet ajo këngë për trimin.

## LAVDIA DHE DETYRA

Lavdinë e shekujve s'e duam jastëk.  
S'na verbon vështrimi i diellit në ikje.  
Më shurdhofshin gjithë stuhitë e deteve  
Në kërkofsha qetësi në vite.

Bri një shkëmbi rri në pozicion.  
Vershëllima erërash zbraps si lis.  
Në s'qëllofsha si më thotë revolucioni,  
Më qëlloftë gjithë breshëri i dimrit të Shqipërisë.

Gjithë fushat e malet në më ftofshin në përleshje  
I patundur do qëndroj si në luftë partizanët,  
Se lavdia ime këto janë në jetë,  
Për to zemra ime është buri në alarme.



## NËNA E USHTARIT

E përcolli djaln për ushtar  
Era fryntë midis gjetheve.  
Nëna hodhi shatin në ugar  
«Udhë të mbarë o bij», — u tha rekrutëve.

Era fryu mbi rrugën e madhe  
Dhe shamia e nënës u bë flutur,  
Era rendi e lirë nëpër livadhe  
Me këshillat e një nëne mbushur.

## ÇELIN KOPSHTET E KIJTESËS

Çelin lulet, vjen pranvera,  
Lule djem të nënave.  
Ne stolisim lapidaret  
Me kurora maleve.

Çelin lulet e pranverës  
Dhe lëvizin dorë më dorë,  
Bëjnë nipat roje nderi  
Vjen pranvera plot kurorë.

Çelin kopshtet e kujtesës  
Dhe na dalin pranë e pranë  
Lule djem, lule petrita  
Për botën e kuqe ranë.

Çelin lulet, vjen pranvera,  
Lule djemtë që malit ranë,  
Komunizmi mes fitores  
Lapidarët lart i mban.

## BALLADA E MALIT

*Kushtuar  
heroinës P. Kokëdhima*

Perso, krojet e maleve  
Derdheshin si ujvara,  
Nëneja priste vajzën-o,  
Nëna mendilezeza.

Qitrot nuk nxorën lule më,  
Heshtën një natë krojet,  
Malet Akrokeraunë  
Hodhën në det dëboje.

Perso, dyert e fshatrave  
Kërcisnin nëpër netë,  
Nën rrap të shfaqej si pëllumb  
Bregu i vendlindjes tënde.



Perso, rrugët e lagjeve  
Të çonin nëpër male,  
Përcillnin nënat bijtë mbi udhë,  
Nënat mendilezeza.

Erdhën një vjeshtë zogjtë e parë  
Mbi portokallë qëndruan,  
Dhe sollën lajmin që nga larg  
Pranë viseve të tua.

Erdhën një vjeshtë zogjtë e parë  
Kaluan mbi vëndlindje,  
Kur ty të hidhnin një litar  
Ti e pamposhtur ishe.

Perso, nga maja e degëve  
Shpërthenin lart ylbere,  
Tutje në male përmbi armë  
Seç vërshëllente era.

Perso, të vinin prapë përreth  
Bulja, vëndlindja, këngët,  
N'apel Akrokeraunet  
S'harruan ikjen tënde.

Dhe kur nga shtegu përmbi mal  
Dëboje binin honit,  
Gjëmonte zëri partizan  
O Perso, Persefoni!

Dhe kur nga bregu me limonj  
Kopshtijet lart bulonin  
Dhe zogjtë çurisnin mbi limonj  
O Perso, Persefoni!

Kur çeta e malit si mëngjez  
Zbriti në kodra e pllaja  
Dolën në lagje prisnin djemtë  
Nënat mendilezeza.

Dhe në apelin madhështor  
Ushtoi vargmali, honi,  
Nuk të harroi vendlindja ty  
Moj Perso, Persefoni!

Dhe qitrot nxorën lule prapë,  
Fryn flladi blerimsjellës,  
Në gjoks t'Akrokeraunëve,  
Në brigjet e rivierës.

## KANGJELAT E DE RADËS

Gjithë lulet e pranverës  
Ti i shkunde mbi kangjelat  
Të mbuloi dhe ty pranvera  
Flokëbardhë, poet De Radë.

O, ç'këndojnë dhe gjelat në kangjelat,  
Bota lisat ndrroi përsëri,  
Ti u trete përtej detit flokëbardhë,  
Feksi dita e bardhë në Arbëri.

Vallë i tund dëbora pemët,  
Vallë i mplak dëbora lisat?  
Ty poet s'të plakën thinjat,  
Je i gjallë në këto vise.

Rri vështron nga busti i derdhur  
Si pranë teje vijnë fëmijët  
Të mbulojnë me krisanthea  
Dhe mbi bust dielli bie.



Blegërijnë delet në brigje  
Se bari të kanë De Radë,  
Në kangjelat grigje-grigje,  
Nëpër mandrat radhë-radhë.

Rri i qetë në breg të detit  
Pulëbardhat të vijnë rrotull.  
S'tundet mali nga tërmeti  
Erdhi dita e Arbërit.

Blegërijnë në brigje delet,  
Ç'ke një mall për Arbërinë,  
Prapa maleve që deshe  
Feksi dita e Arbërit.

## VETMI

Ju iknit në një vetmi të huaj drejt kurbetit të largët.

(Kush ju ndiqte pas,

Kush ju ndoqi pas?)

Mjerimi u dëbonte nga shtëpitë tuaja,

O njerëz që mbetët pa një ditë dashurie,

Në tokën e huaj, u kalbët nën shi!

Vizionet tuaja mbetën të lotuara.

Ju kujtohej çasti i ndarjes, kthesa te përroi, familja

tutje që tundte shaminë me lot.

Ç'ju kishte mbetur mbi dhe në rrugët e kurbetit?

Ju kishit aq njerëz dhe atje s'kishit asnjë.

Ndonjëri ndoshta nxirrte nga xhepi fotografinë e

familjes

Të nxjerrë nga fotografisti shetitës një herë në

dhjetë vjet.

Më i afërti send për ju në kurbetin e largët

për të shuar mallin në çastet e vetmisë.

Dhe mendoni për një dashuri.

Ju hante merakun për vajzat që bëheshin nuse pa  
prind...

Në netët e largëta të kurbetit binte shi.  
S'dihej ç'ishte ky shi  
Ishte shi apo djersë e lot mërgimtarësh?

Ju mbeteshit në vetmi në kurbetin e largët,  
Ju priteshin duart dhe këmbët  
Dhe ju shtrydhnin e ju shanin padronët...

Ju nxirrnit nga xhepi të lagur fotografinë e shtëpisë.  
Ndoshta larg në atdhe atëherë trokiste në derë  
xhelepi  
Dhe bashkë me xhelepin hynte në derë dhe karta  
e zezë.

(Sa letra të tilla, të zeza pritën anët tona!)  
Letrat e zeza vinin bashkë me xhelepin e shtëpisë.  
Dhe të nesërmen pezullohej një dasmë.  
Zbarkonin në molot tona anijet arkaike me vela,  
Dhe nuk sillnin kufomën,  
Por sillnin lajme të zeza.

Pastaj sollëm një stinë që nuk lejoi kurrë karta  
të tilla!

Kthehen të mërguarit!  
Mbeten vetëm mallëkimet për të largëtin kurbet.



## POETIT ZEF SEREMBE

Qershia u tha në derën e shtëpisë  
Dhe zogu që këndoi pranë gjethit heshti,  
Katundin prapa le në netët me vetmi  
Dhe nën një tjetër qiell mbete në kurbet

Qershia priste derës së shtëpisë  
Të nxirrte sytha prapë nga ardhja e poetit  
Pëllëmbë-pëllëmbë kërkoje varrin e një vajze  
në Brazil  
Që si pëllumb të fluturoi përtej detit.

Në hyrjen e vorrezave të shihnin  
Mesnatës dhe mesditës tek kërkoje,  
Me mall kujtoje netët e katundit  
Dhe dashuritë e shfaqura ndanë kroit.

Dhe ike pas një vajze të bardhë  
Dhe prapa le katundin, shtëpinë tënde,  
Kurse nën hënë, n'oborrin rreth me gardh  
Lexojnë lirikat vajzat, o Serembe.

Qershia u tha në derën e shtëpisë,  
Ti pas një vajze tej Brazilit ike.  
Vajzat e fshatit vjershat t'i bënë këngë  
Dhe mbete strofë mes strofave lirike.

## BISEDË ME MAJAKOVSKIN

(Për poezinë dhe politikën)

Tetori erdhi përsëri  
me erëra, brerime  
Rënqethja e gjetheve që bien  
të sjell ndërmend kujtime.

Tetori erdhi përsëri  
sa ftohtë që ndjen pranë bustit  
O burrë i ndershëm Majakovski  
që erërat përbuze!

Tetori erdhi përsëri  
në vendin tënd me shira  
Tradhëti e tmerrëshme rrëzoi  
shtete, parti, kështjella.

■  
Ej Majakovski ç'tu rrudh balli  
mbi vargun bomb e flamur,  
Sa i urreve ti kolltuket  
me poetucë të majmur.  
Ej Majakovski, Majakovski,  
me zërin tënd të ngjeshur,  
Dil përsëri me poezinë  
në fushë për t'u përleshur.





Të digjen gjëmbat që nga rrënjët  
të ngrihen prapë miljonat.

■  
Në netët ruse e ditët ruse  
u fut pyk e huaj  
Dhe e harruan vargun tënd  
të ndezurin vargun tënd  
Po ti ke mbetur zjarr i madh  
ylber i ndezur rri mbi glob,  
S'të tremb kurrë lehja e tradhëtisë,  
as dhe thellimi me galop.  
Vargu yt është bombë e Vladimir  
dhe prapë do të pëlçasë  
Nga gjoksi i masës do shpërthej  
dhe do vërsulet mbi Kremlin  
Vargun të mirë e deshe ti  
pranë tokës dhe kombajnës  
Dhe jo të mykur si një zilkë  
nën gjëmimin e kambanës.  
Duam stuhi dhe uragan  
vargun për klasën e duam  
Punëtorë, kombajna e gjallëri  
si në vargjet e tua?

■  
Dhe vijnë e thahen stepat ruse  
nga xhazi i marrë i perëndimit  
Nga tymi i puros së borgjezit  
me viski e vodka dimrit.

Le të gjëmojnë prapë Aurora  
edhe Ivani rus  
Të tundet stepa që venitet  
zinxhirat t'i këpusë  
Dhe prapë me ta si top' i hekurt  
me vargun tënd do rendësh  
Si një furtunë që ngrihet shpejt  
me vorbulla mbi dete



Tmerrshëm të ngrihet me gjënim  
furtuna proletare  
T'i mbysë xhambazët që po shesin  
atdheun për pesë pare,  
T'i mbysë ata që cicërijnë  
për shpirtin, poetucët,  
Që kabareve dehur klithin,  
dhe rrinë lustrojnë këpucët.



Kështu e deshe vargun shok  
sa herë na porosite  
Që në filozofinë e pellgut  
poeti të mos mbytet.  
Ne dimë kaq shumë të dashurojmë  
po kaq dhe të urrejmë  
Ne dimë të shembim burokratin  
punëtorin lart ta ngrejme.





Që në tërmet të tundet stepa  
nga marshi e zëri bas.  
Ndezur nën këmbë, toka të tundet  
të brumbullojë baroti  
Që mos ta brejë erozjoni,  
as shiu, as ngrica, as moti,  
Të ngrihet si feniks i madh  
e kuqe puntoria  
Nga brigje detesh, nga metrotë  
nga dunat, malet, pyjet.  
Besimi lart, besimi lart  
në ballë klasa puntore  
Si me Leninin dhe Stalinin  
në luftrat, pesvjeçaret.  
Tashti duhet lëvizje, o popull  
pamfletë, armë e trakte  
Të tundet borgjezia e vendit  
në vila dhe pallate.  
Nëpër beteja, proletare  
të gjëmojë zëri juaj  
Dhe fatin vetë mirrni në dorë  
bilardo mos ta luajnë.



Në sytë e Gorkit det' i gjerë  
ku fluturojnë zgalemat  
Që kërkojnë dritë të bjerë mbi tokë  
dhe të blerojnë pemët.

Se ja furtuna, vjen furtuna  
vërtitet nëpër boshte  
Të fshijë nga dheu reaksionin  
dhe të pastrojë qoshet

■  
Si ujqër dhëmbët nxorën jashtë  
një natë vere nën hënë  
Dendur mbi trojet hodhën tanket  
dhe invadorë u bënë.  
Dhe kur puntorët ngriten armët  
për lirinë Majakovski.  
U doli nëpër natë si djall,  
gravura e Jakubovskit.

■  
Partia ime Majakovski  
mban lart flamujt e punës  
Në fryfshin erërat e marra,  
ne do t'i ngjajmë furtunës.  
Partia ime, Majakovski  
mban lart Lenin-Stalinin  
Dhe para popullit e pastër  
partia bën betimin.  
Korrjet i kemi të begata,  
dhe fushat plot traktorë  
Në rrugën tonë i gjallë na vjen  
kontrolli punëtor.





Tetori erdhi përsëri  
me erëra, brerime  
Rënqethja e gjetheve që bien  
të sjell ndërmend kujtime.  
Tetori erdhi përsëri  
sa ftohtë që ndjen pranë bustit  
O burrë i ndershëm Majakovski  
që erërat përbuze.  
Tetori erdhi përsëri  
në vendin tënd me shira  
Tradhëti e tmerrëshme rrëzoi  
shtete, parti, kështjella.  
Ej Majakovski, Majakovski  
me zërin tënd të ngjeshur  
Dil përsëri me poezinë  
në fushë për t'u përleshur.

## E FSHEHTA E KËSAJ MBRËMJE

Mbrëmë ishte mbledhur familja në dhomë  
Dhe unë isha kthyer në shtëpi.

Në mbrëmjen e verës pranë dritares rrija  
Si një astronom zbuloja yjet.

S'isha astronom këtë mbrëmje  
Ndoshta qesh poet, dashnor a diçka tjetër

U rrite — tha nëna mbrëmë në shtëpi  
Gjeje vetë nusen tënde dhe leri yjet.

Si e zbuloi nëna ime të fshehtën e mbrëmjes  
Mes mirazhit që dridhej nga hëna?

Nëna, e mira nënë!

## PËRMBAJTJA

Faqe

Sikur më thonë malet e vendlindjes .....	3
Pallati i progresit teknik .....	4
Një natë në mal .....	6
Për drerin, për drurin, për dritat .....	8
Kros vjeshte .....	10
Rrëmbimi i statujave të Butrintit .....	12
Sonte .....	15
Natë me hënë të ëmbël mjaltë .....	17
Peisazhet çelin lule .....	18
Fluturimi i zogut .....	20
Gjer te praku i portës të përçolla mbrëmë .....	22
Kur doli ylli i karvanit .....	23
Qyteti gurit .....	26
Kthimi i të treqindve .....	29
Balladë .....	30
Plaku dhe plagët .....	31
Drama e orizit që s'u korr .....	32
Na zuri agimi mbi skela .....	35
Zbres në rrugë vetë i dytë .....	36
Diçka thanë panjat dhe çelën .....	37
Më ndoqi larg vegimi yt .....	38
Nga plepat doli hëna .....	39
Fëminia, unë dhe shoku .....	40
Zogu i dëborës .....	42



	Faqe
Vajza në fortepiano .....	43
Fundi i dhjetorit .....	45
Tunden gjethet nëpër këngën tënde .....	47
Lavdia dhe detyra .....	49
Nëna e ushtarit .....	50
Çelin kopshtet e kujtesës .....	51
Ballada e malit .....	52
Kangjelat e De Radës .....	55
Vetmi. ....	57
Poetit Zef Serembe .....	59
Bisedë me Majakovskin .....	61
E fshehta e kësaj mbrëmje. ....	69

BIBLIOTEKA E SHETIT  
GJROKASTER

55804

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

---

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1970